



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 nr. 76-2/2014

Kuvendi komunal Rahovec, duke vendosur sipas Propozimit të Kryetarit të komunës 01 nr. 75/2014 të dt. 2. 07. 2014 me qëllim të realizimit të interesit të veçantë publik për zhvillimin ekonomik të komunës dhe kthimit të pronës së paluajtshme të ish Ndërmarrjes shoqërore NBI “Rahoveci” që tani administrohet dhe menaxhohet nga AKP-ja, në emër të komunës së Rahovecit, në bazë të nenit 4. pika 1.5 dhe nenit 12 pika 2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nr. 04/L-144 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 35/ 17 dhjetor 2012, nenit 19 të Rregullores së QRK për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/ 15 qershor 2008, nenit 115 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nr. 03/L-154, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 175/ 25 qershor 2009, nenit 13 dhe 84 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28 “Gazeta zyrtare nr. 8/ 2 janar 2007 dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit 01 nr. 569/1 të dt. 6. 12. 2010, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 28 gusht 2014, merr

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi për shpalljen e interesit të veçantë Publik dhe kthimin e një pjese të pronës nga NBI “Rahoveci” në emër të komunës së Rahovecit 01 nr. 76/2014 të dt. 30. 07. 2014.
- II. Shpallet interesi Publik në pronën e paluajtshme të NBI “Rahoveci”, duke përfshirë disa zona kadastrale në territorin e komunës së Rahovecit dhe ato:

1. z.k. Bellacërkë:

Ngastrat nr. 1000-0, kullosë në sipërfaqe prej 1821 m²; 1007-0 kullosë në sipërfaqe prej 6184 m²; 1008-0, kullosë në sipërfaqe prej 256 m², që gjenden në kufi të fshatit, janë të lira, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllimi por janë të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, ndërsa ngastra nr. 2294-0 kullosë në sipërfaqe prej 29460 m² gjendet në periferi të fshatit dhe shfrytëzohet për kullotjen e bagëtive. Të gjitha ngastrat evidentohen në emër të PSH Kosovës, KK Rahovec – Shfrytëzuese NBI “Rahoveci”, sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 115.

Sipërfaqja e përgjithshme: 3.77,01 ha.

2.- z.k. Bërnjakë

Ngastrat nr. 514, djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 4204 m²; 515 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 400 m²; 518 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 1455 m²; 519 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 1525 m²; 540 djerrinë në sipërfaqe prej 4490 m²; 541 djerrinë në sipërfaqe prej 802 m² dhe ngastra nr. 542 kullosë në sipërfaqe prej 2876 m², janë të lira, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime, por janë shumë afër fshatit dhe mund të përfshihen në rajonin e ngushtë ndërtimor dhe ato të shpallen si zonë e veçantë e interesit publik, ndërsa ngastrat numër: 809 kullosë në sipërfaqe prej 3202 m²; 810 jopjellore në sipërfaqe prej 688 m²; 811, arë në sipërfaqe prej 2464 m²; 812 arë në sipërfaqe prej 1047 m²; 840, arë në sipërfaqe prej 6133 m²; 841 arë në sipërfaqe prej 2232 m² dhe ngastra nr. 842 arë në sipërfaqe prej 2222 m², të gjitha nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 8, në emër të PSH KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci" janë të përshtatshme për zhvillimin e biznesit ekonomik.

Sipërfaqja e përgjithshme është 3.37,40 ha.

3.- z.k. Celinë

Ngastra nr. 41-2 djerrinë e fshatit, në sipërfaqe prej 1523 m², është e lirë dhe nuk shfrytëzohet për kurrfarë qëllimi nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 82.

4.- z.k. Dobidol

Ngastrat nr. 93, djerrinë në sipërfaqe prej 571 m² dhe 93 djerrinë në sipërfaqe prej 436 m², gjenden brenda fshatit, ndërsa ngastra nr. 397 në sipërfaqe prej 1166 m² gjendet në kufi me fshatin. Të gjitha ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 112 PSH e Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 0.21,73 ha

5.- z.k. Dejn

Në ngastrën nr. 428 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 10459 m² ekziston Tyrbe, ngastra nr. 434 kullosë në sipërfaqe prej 3943 m², dhe ngastra nr. 507 në sipërfaqe prej 8261 m², janë djerrina të fshatit dhe shfrytëzohen për kullotjen e bagëtisë, ndërsa ngastra nr. 1154 në sipërfaqe prej 5033 m², është kodrinë, nuk shfrytëzohet për kurrfarë qëllimi por kufizohet me fshatin dhe me rrafshimin e një pjese të saj mund të shpallet si zonë e veçantë me karakter biznesi. Të gjitha ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 129 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme 2.80,02 ha.

6. z.k. Çifllak

Ngastra nr. 163 në sipërfaqe prej 260 m² dhe ngastra nr. 168 në sipërfaqe prej 298 m², kufizohen me varreza myslimane dhe janë të përshtatshme për zgjerimin e këtyre varrezave. Ngastrat nr. 172 kullosë në sipërfaqe prej 927 m² dhe ngastra nr. 175 kullosë në sipërfaqe prej 3269 m² janë afër fshatit dhe trajtohen si djerrinat e fshatit, të cilat përveç kullotjes nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime tjera. Ngastrat nr. 795 jopjellore në sipërfaqe prej 1985 m² dhe ngastra nr. 796 jopjellore në sipërfaqe prej 2245 m² gjenden afër fshatit, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime dhe mund të jenë me interes të komunës me karakter biznesi. Të gjitha ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 86 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 0.89,84 ha.

7. z.k. Gexhe

Ngastrat nr. 57 djerrinë e fshatit, në sipërfaqe 4872 m²; 58 djerrinë e fshatit, në sipërfaqe prej 3077; 77 mal në sipërfaqe prej 361 m²; 78 mal në sipërfaqe prej 1626 m²; 84 mal në sipërfaqe prej 1700 m²; 85 mal në sipërfaqe prej 980 m²; 86 mal në sipërfaqe prej 225 m²; 87 kullosë në sipërfaqe prej 650 m²; 88 kullosë në sipërfaqe prej 515 m²; 89 mal në sipërfaqe prej 480 m². Këto ngastra gjenden në periferi të fshatit dhe nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime, ndërsa ngastrat 95 në sipërfaqe prej 1660 m²; 252 në sipërfaqe prej 978 m²; 339 në sipërfaqe prej 6474 m²; 341 në sipërfaqe prej 9727 m² dhe ngastra nr. 342 në sipërfaqe prej 3778 m² përveç kullotjen e bagëtive nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime tjera.

Sipërfaqja e përgjithshme është 2.35,98 ha.

8. z.k. Krushë e Madhe

Ngastrat nr. 462-1 në sipërfaqe prej 5104 m²; 462-2 në sipërfaqe prej 5747 m²; 464-2 në sipërfaqe prej 9002 m²; 647 në sipërfaqe prej 2564 m²; 679/1 në sipërfaqe prej 5496 m²; 696 në sipërfaqe prej 6550 m² dhe ngastra nr. 764 në sipërfaqe prej 3097 m², gjenden në periferi të fshatit dhe shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive, ndërsa ngastra nr. 2076-2, kullosë në sipërfaqe prej 37064 m² gjendet në brendësi të fshatit në të cilën ekzistojnë disa objekte ndërtimore të cilët dikur kanë shërbyer për nevojat e zhvillimit të blegtorisë, ndërsa tani kjo sipërfaqe shfrytëzohet nga ish pronarët të mëparshëm të cilët pronë e kanë fituar në procedurë gjyqësore, mirëpo aktgjykimet të plotfuqishme në elaboratin kadastral nuk janë ekzekutuar për shkak të moszbatimit të tyre në procedurën e komasacionit. Të gjitha ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 276 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 7.46,24 ha

9. z.k. Nashpall

Ngastrat nr. 112 kullosë në sipërfaqe prej 23833 m², në të cilën ekzistojnë disa vorre dhe ngastra nr. 114 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 62663 m² e cila përveç kullotjen e bagëtive nuk shfrytëzohet për kurrfarë qëllime tjera. Për shkak të konfiguracionit jo të përshtatshëm me rrafshimin e një pjese të sipërfaqes së sajë kjo ngastër mund të shpallet si zonë e veçantë e interesit të përgjithshëm për zhvillimin e biznesit. Ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 43 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci"

Sipërfaqja e përgjithshme është 8.64,96 ha.

10. z.k. Apterushë

Ngastrat nr. 119, kullosë në sipërfaqe prej 2862 m², 132 kullosë në sipërfaqe prej 12619 m²; 380 kullosë në sipërfaqe prej 1132 m²; 480 arë në sipërfaqe prej 6187 m²; 795 kullosë në sipërfaqe prej 5385 m² tani trajtohen si djerrinat e fshatit për kullotjen e bagëtisë; ngastrat nr. 1142 kullosë në sipërfaqe prej 4523 m²; 1264 kullosë në sipërfaqe prej 1497 m²; 1288 mal në sipërfaqe prej 201 m² dhe 1414 kullosë në sipërfaqe prej 1464 m² gjenden në periferi të fshatit, për të cilat mund të shpallet zonë e veçantë e interesit publik për zhvillimin ekonomik me karakter biznesi. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 164 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme 4.27,32 ha.

11. z.k. Ratkoc

Ngastrat nr. 147, mal në sipërfaqe prej 646 m²; 436-3 kullosë në sipërfaqe prej 5287 m²; 445 kullosë në sipërfaqe prej 5809 m²; 446 kullosë në sipërfaqe prej 1483 m² të cilët shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të fshatit, ngastra nr. 1532 objekt i Stacionit hekurudhor të shkatërruar në sipërfaqe prej 29 m²; 1535 kullosë në sipërfaqe prej 866 m²; 1537 kullosë në sipërfaqe prej 8450 m²; 1538-1, kullosë në sipërfaqe prej 1573 m²; 1546 kullosë në sipërfaqe prej 1408 m²; 1547 kullosë në sipërfaqe prej 1508 m²; 1588 kullosë në sipërfaqe prej 958 m². Këto ngastra gjenden pranë hekurudhës, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime, janë shumë afër fshatit dhe mund të shpallen si zonë e veçantë e interesit publik për zhvillimin ekonomik me karakter biznesi. Ngastrat nr. 1635 në sipërfaqe prej 6764 m²; 1650 në sipërfaqe prej 184 m²; 1659 në sipërfaqe prej 3028 m²; 1681 në sipërfaqe prej 3715 m², gjenden në brendi të fshatit dhe mund të përfshihen në rajonin e ngushtë ndërtimor, ndërsa ngastrat nr. 1694 në sipërfaqe prej 11105 m²; 1704 në sipërfaqe prej 2011 m²; 1705 në sipërfaqe prej 11365 m²; 2014-2 në sipërfaqe prej 34353 m² dhe ngastra nr 2014-4 në sipërfaqe prej 5451 m² trajtohen si djerrinat dhe shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të fshatit. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 258 në emër të PSH të Kosovës KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme 10.67,28 ha.

12. z.k. Rahovec

Ngastra nr. 2141-2, tokë ndërtimore brenda qytetit, në sipërfaqe prej 3857 m² dhe ngastra nr. 7186-4, tokë urbane në sipërfaqe prej 1506 m², të dyja nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 4412, në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci", janë të lira dhe mund të shpallen si zonë e veçantë e interesit publik komunal për zhvillimin ekonomik me karakter biznesi.

Ngastrat nr. 1315 tokë urbane afër hotelit në sipërfaqe prej 2918 m², e përshtatshme për parkingun e automjeteve, ngastra nr. 1997-7 tokë urbane në sipërfaqe prej 2583 m², e përshtatshme për zgjerimin e oborrit të shkollës "7 shtatori" dhe ngastra nr. 6638-3 tokë rurale në sipërfaqe prej 11715 e cila shfrytëzohet nga bujqit të cilët kanë fituar të drejtën e pronësisë në pjesën e kësaj ngastre në procedurën e arondimit të tokës në vitin 1967 nga ana e KK Rahovecit, por për shkak të mos kufizimit dhe formimit të ngastrave të reja aktvendimet edhe pse kanë marrë formën e prerë nuk janë ekzekutuar në elaboratin kadastral. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 984 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 2.25,89 ha.

13. z.k. Potočan i Epërm

Ngastrat nr. 5 mal në sipërfaqe prej 271 m²; 6 kullosë në sipërfaqe prej 1525 m², 7 kullosë në sipërfaqe 221 m²; 54 kullosë në sipërfaqe prej 1429 m²; 98 kullosë në sipërfaqe prej 2685 m²; 114 arë në sipërfaqe prej 3337 m²; 116 arë në sipërfaqe prej 5486 m². Këto ngastra shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të fshatit, ndërsa ngastrat nr. 169 (mal kaçuba) në sipërfaqe prej 3459 m²; 170 (mal kaçuba); 171, kullosë në sipërfaqe prej 880 m² dhe ngastra nr. 172 kullosë në sipërfaqe prej 1720 m², janë të lira, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime por mund të shfrytëzohen për zgjerimin e oborrit të shkollës fillore. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 102 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 2.01,73 ha.

14. z.k. Vrajak – Ngastrat nr. 10, kullosë në sipërfaqe prej 1837 m²; 13, kullosë në sipërfaqe prej 2576 m² dhe 22 mal (kaçuba) në sipërfaqe prej 12909 m², shfrytëzohen për kullotjen e bagëtisë së fshatit, ndërsa ngastrat nr. 431 mal në sipërfaqe prej 1233 m²; 432 mal në sipërfaqe prej 3835 m² dhe ngastra 433 mal (kaçuba) në sipërfaqe prej 762 m² gjenden shumë afër fshatit, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime dhe mund të shpallen si zonë e veçantë e interesit publik për zhvillimin ekonomik të komunës me karakter biznesi. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 72 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme 2.31,52 ha

15. z.k. Xërxë

Ngastrat nr. 410 kullosë në sipërfaqe prej 2398 m²; 495 kullosë në sipërfaqe prej 6153 m², 495 kullosë në sipërfaqe prej 1799 m²; 495-3 kullosë në sipërfaqe prej 4534 m²; 495-7 kullosë në sipërfaqe prej 3230 m²; 496-1 kullosë në sipërfaqe prej 2898 m²; 502 kullosë në sipërfaqe prej 2248 m²; 503 kullosë në sipërfaqe prej 515 m² dhe 505-3 kullosë në sipërfaqe prej 2726 m², janë djerrinat e fshatit, të përfshirë në rajonin e ngushtë ndërtimor, nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime, ndërsa komuna ka interes që këto ngastra të shpalli si zonat e veçanta të interesit publik për zhvillimin ekonomik të komunës me karakter biznesi. Ngastrat nr. 808-1 kullosë në sipërfaqe prej 13113 m²; 808-4 kullosë në sipërfaqe prej 1012 m² dhe ngastra nr. 928 kullosë në sipërfaqe prej 1228 m², shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të fshatit, ndërsa ngastra nr. 1035 në sipërfaqe prej 2252 m², pjesërisht gjendet në kuadër të depos të cilën para luftës në Kosovës e ka shfrytëzuar për qëllimet e veta ish Armata Jugosllave, ndërsa tani ato lokale shfrytëzohen nga afaristët të ndryshim me kompensim në formë të qirasë sipas tarifës komunale. Ngastra nr. 1519-4, gjendet në brendësi të fshatit si enklavë dhe nuk shfrytëzohet për kurrfarë qëllime, ndërsa ngastrat nr. 1615-2 kullosë në sipërfaqe prej 1334 m²; 1623, kullosë në sipërfaqe prej 7597 m²; ngastra nr. 1634, kullosë në sipërfaqe prej 1599 m², ngastra nr. 1736 jopjellore, në sipërfaqe prej 501 m²; ngastra nr. 1751 jopjellore, në sipërfaqe prej 461 m² 1753, jopjellore në sipërfaqe prej 1287 m² dhe ngastra nr. 1778 kullosë, në sipërfaqe prej 3404 m², shfrytëzohen për kullotjen e bagëtisë së fshatit. Të gjitha këto ngastra evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 98 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 6.16,13 ha.

16. z.k. Hoçë e Madhe

Ngastrat nr. 212 kullosë në sipërfaqe prej 2221 m²; 219 kullosë në sipërfaqe prej 7857 m²; 228 kullosë në sipërfaqe prej 2246 m² dhe ngastra 211 kullosë në sipërfaqe prej 2564 m² gjenden në periferi të fshatit dhe shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive, ndërsa ngastrat nr.:

-383 kullosë në sipërfaqe prej 316 m²; 389 kullosë në sipërfaqe prej 1625 m²; 392 kullosë në sipërfaqe prej 733 m²; 393 kullosë në sipërfaqe prej 316 m²; 394 kullosë në sipërfaqe prej 1809 m²; 395 kullosë në sipërfaqe prej 293 m²; 396 kullosë në sipërfaqe prej 291 m²; 397 kullosë në sipërfaqe prej 1882 m²; 398 kullosë në sipërfaqe prej 341 m²; 399 kullosë në sipërfaqe prej 2380 m²; 426 jopjellore në sipërfaqe prej 485 m²; 427 jopjellore në sipërfaqe prej 230 m²; 428 kullosë në sipërfaqe prej 2773 m²; 456 objekt i shkatërruar ndërtimor në sipërfaqe prej 63 m²; 472 kullosë në sipërfaqe prej 971 m²; 775-4 kullosë në sipërfaqe prej 882 m²; 786 kullosë në sipërfaqe prej 2781 m²; 787 kullosë në sipërfaqe prej 1005 m²; 821 kullosë në sipërfaqe prej 290 m²; 939 arë në sipërfaqe prej 2223 m²; 972 arë në sipërfaqe prej 757 m², 973 arë në sipërfaqe prej 4590 m²; 985 kullosë në sipërfaqe prej 411 m²; 986 kullosë në sipërfaqe prej 2283 m²; 987 kullosë në sipërfaqe prej 1108 m²; 1584, djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 7805 m²; 1588 djerrinë e fshatit në sipërfaqe prej 523 m²; 1719 jopjellore në sipërfaqe prej 1721 m²; 1736 kullosë në sipërfaqe prej 1609 m²,

ngastra nr. 1776 kullosë në sipërfaqe prej 400 m², dhe ngastra nr. 2007 n; sipërfaqe prej 5915 m² në bazë të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe nr. 04/L-062 dhe Ligjit për Zonat të veçanta të mbrojtura nr. 03/L-039, këto ngastra janë klasifikuar si Zonat e veçanta të mbrojtura, në përputhje me dispozitat relevante të legjislacionit mbi vetëqeverisjen lokale dhe Ligjit për trashëgiminë kulturore me qëllim që kjo zonë të mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet tjetër i cili mund të dëmtojë interesat historike dhe kulturore të komunitetit serb dhe Kishës Ortodokse Serbe në Hoçë të Madhe. Kjo zonë është caktuar me një sipërfaqe të kufizuar sipas hartës së Agjencionit Kadastral të Kosovës, i cili lokacion sipas Ligjit për Zonat e veçanta të mbrojtura konsiderohet territor historik dhe kulturor me rëndësi të veçantë për komunitetin serb. Të gjitha ngastrat evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 4 në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues NBI "Rahoveci".

Sipërfaqja e përgjithshme është 6.14,72 ha

III. Me këtë Vendim të njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 76-2/2014

Rahovec, 28. 08. 2014

**Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani**

